




Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY



Zyra e Drejtorit - Kancelarija Direktora - Office of the Director

DATË/A:	07.05.2015
REFERENC-Ë:	Ref. AKK-ZD
PËR/ZA/TO:	Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Kryetarët e Gjykatave Themelore
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Analizë e politikës ndëshkimore për veprat penale të Mos deklarimit ose deklarimit të rremë të pasurisë

Të nderuar,

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë përmbushjes së mandatit të saj ligjor, përkatësisht paraqitjes së kallëzimeve penale për vepra penale me natyrë të korrupsionit, ka konstatuar disa mangësi në punën e gjykatave themelore në Kosovë. Gjatë përfaqësimit të rasteve të iniciuara nga Agjencia është vërejtur se gjykatat themelore në Kosovë kanë aplikuar një politikë joadekuate ndëshkimore, veçanërisht në lidhje me veprat penale Të mos deklarimit ose deklarimit të rremë të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik, sipas nenit 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës.

Përmes kësaj shkrese, duam që të tërheqim vërejtjen e opinionit publik dhe të ju vejmë në dijeni përgjegjësit e institucioneve të drejtësisë, në lidhje me politikën joadekuate ndëshkimore të cilën e kanë aplikuar gjykatat në lidhje me këto vepra.

Nga rastet e gjykuara dhe të vendosura nga gjykatat themelore, të cilat janë analizuar në bazë të aktgjykimeve të dhëna për këto raste, mund të nxirren këto karakteristika kryesore:

1. Dhënia e aktgjykimeve liruese në mungesë të vërtetimit të dashjes së kryerësve;
2. Dhënia e aktgjykimeve liruese në mungesë të konstatimit të drejtë të së vërtetës materiale;
3. Caktimi i dënimeve minimale në rastet kur janë dhënë aktgjykime dënuese;

4. Mos efikasiteti i gjykatave në trajtimin e veprave penale të Mos deklamimit ose deklarimit të rremë të pasurisë.

1. Dhënia e aktgjykimeve liruese në mungesë të vërtetimit të dashjes së kryerësve

Gjykatat themelore kanë dhënë katër aktgjykime liruese, ku të akuzuar kanë qenë zyrtarë të lartë publik, me arsyetimin se nuk është vërtetuar dashja për kryerjen e veprës penale. Sa i përket dashjes, ne vlerësojmë se dashja është element subjektiv i veprës penale, i cili është vështirë që të vërtetohet. Ajo që është e rëndësishme është fakti se Agjencia si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, edhe pa vërtetimin e dashjes së kryerësit në lidhje me veprat penale të deklarimit të pasurisë, ka bazë të mjaftueshme ligjore që të paraqesë kallëzime penale. Sipas Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave, Agjencia është e obliguar që të paraqes kallëzime penale ndaj zyrtarëve të lartë publik, në rastet kur ata, me ose pa dashje:

- Nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë në afatin e paraparë ligjor ashtu edhe
- Në rastet kur kanë bërë deklarim të rremë.

2. Dhënia e aktgjykimeve liruese në mungesë të konstatimit të drejtë të së vërtetës materiale

Gjykata ka dhënë aktgjykim lirues në rastin e një Këshilltareje komunale, mbi bazë të vlerësimit se vepra për të cilën është akuzuar ajo nuk përbën vepër penale por kundërvajtje. Në këtë rast, i cili përbën precedent të rrezikshëm, gjykata ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Ju kujtojmë se zyrtarja e lartë publike nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë në muajin mars 2013, deklarim që përfshinë gjendjen e pasurisë për vitin paraprak. Mos deklarimi i pasurisë është paraparë si vepër penale që nga data 01.01.2013. Meqenëse periudha e deklarimit të pasurisë në rastin konkret, po ashtu edhe pasojat janë shkaktuar në muajin mars të vitit 2013, ky rast përbën vepër penale, pavarësisht faktit se deklarimi përfshinë gjendjen e pasurisë për vitin paraprak.

Sipas parimit të zbatimit në kohë të legjislacionit penal (shih nenin 9 të KP), vepra penale kryhet në kohën kur ndërmerren veprimet e kryerjes, ose në kohën kur kryerësi ka qenë i detyruar të veprojë, pavarësisht kohës kur është shkaktuar pasoja. Se ky rast përbën vepër penale nuk ka dyshim, gjë të cilën e vërteton edhe Mendimi juridik i Gjykatës Supreme, nr. GjA nr. 43/2013, datë 15.01.2013, në lidhje me zbatimin e legjislacionit penal nga hyrje në fuqi të Kodit Penal nga data 01.01.2013.

Bazuar në faktet e lartpërmendura, duke e zbatuar gabimisht të drejtën materiale, gjykata në këtë rast penal kë bërë kualifikim të gabuar të veprës, të cilën e ka cilësuar si kundërvajtje e jo vepër penale, pavarësisht se vepra ishte paraparë si vepër penale.

3. Caktimi i dënimeve minimale në rastet kur janë dhënë aktgjykime dënuese

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë caktuar dënime kumulative me gjobë dhe burgim. Dënimet me gjobë janë caktuar në shumë prej 200 deri në 1000 Euro, ndërsa dënimet me burg në kohëzgjatje prej 2 deri në 6 muaj. Dënimet me gjobë është caktuar që të paguhen kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste prej 4 deri në 7 këste, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 Euro do të llogaritet me një ditë burgimi nëse i dënuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim. Dënimet me burgim gjykatat i kanë caktuar si dënime me kusht duke urdhëruar që ato mos të ekzekutohen nëse të dënuarit nuk kryejnë veprë tjetër penale për kohën e verifikimit kryesisht në afat prej 1 viti, apo i kanë shndërruar në dënime me gjobë.

Në vitin e kaluar vetëm dy zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë, ndërkohë që pati shënuar deklarin në nivelin më të lartë që nga viti 2007. Në këtë vit ka një rritje të mos deklarin. Kjo rritje e mos deklarin mund të jetë rezultat i mos sanksionimit adekuat nga ana e gjykatave. Vitin e kaluar kemi qenë të kënaqur me përqindjen e deklarin. Në këtë vit ka një trend më negativ. Arsyeja që sivjet kemi 71 zyrtarë që nuk e kanë deklaruar pasurinë, krahasuar me vetëm dy që ishin vitin e kaluar është fakti i mos sanksionimit nga ana e gjykatave ose sanksionit simbolik. Sidoqoftë, Agjencia ashtu sikurse ka vepruar në të kaluarën, konform nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës do të paraqesë Kallëzime penale në Prokurorinë e Shtetit, ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë publik, që nuk i janë përgjigjur obligimit të tyre ligjor për deklarin e pasurisë, pa dhënë arsye ligjërish të qëndrueshme.

Moszbatimi i politikës adekuate ndëshkimore në lidhje me këto vepra penale ka ndikuar që të mos arrihet qëllimi i dënimet (shih nenin 41 të KP), sepse kjo politikë ndëshkimore nuk e ka arritur efektin e parandalimit të kriminalitetit me natyrë të korrupsionit, ashtu që në të ardhmen kryerësit të mos kryejnë vepra të tilla ose vepra të tjera penale e as të kryerësve të tjerë potencial që të kursehen nga veprat penale. Vlerësojmë se mos aplikimi i politikës ndëshkimore adekuate ndikon në nxitjen e kryerësve të këtyre veprave penale, në mungesë të ndjenjës së frikës nga sanksionimi.

4. Mos efikasiteti i gjykatave në trajtimin e veprave penale të Mos deklarin ose deklarin të rremë të pasurisë

Gjykatat themelore në bazë të rasteve të gjykuara në lidhje me veprat e Mos deklarin të ose deklarin të rreë të pasurisë, nuk kanë treguar efikasitet, ani pse lëndët me vepra penale me natyrë të korrupsionit janë proklamuar si prioritet në punën e gjykatave.

Po ashtu, gjykata nuk ka vepruar brenda afateve të arsyeshme për gjykimin e një rasti, ku një zyrtar i lartë publik (rast i njohur për publikun), nuk e ka bërë deklarin e pasurisë në muajin mars, 2013. I njëjti është deklaruar publikisht në TV, Gazeta dhe Portale se Mos deklarimin e pasurisë e ka bërë me qëllim. Me këtë veprim ai e ka sfiduar shtetin dhe sistemin e drejtësisë. Vlerësojmë se në këtë rast, pasi që mos deklarimi është bërë me qëllim, gjykata është dashur që të veprojë sa më shpejt dhe të njëjtin ta sanksionojë sipas ligjit, në mënyrë që ky sanksionim të ketë efekt edhe në zyrtarët e tjerë që të kryejnë deklarin e pasurisë korrekt dhe në afat, siç është paraparë me ligj. Ky rast përbën shembull të keq, se si një lëndë që është proceduar më 2013, edhe pas dy vjetësh nuk është trajtuar dhe vendosur ende. Është e panatyrshme që të trajtohen rastet e vitit 2014, kurse ato të vitit paraprak, 2013 të neglizhohen.

Mos efikasiteti i gjykatave në lidhje me trajtimin e këtyre lëndëve konstatohet edhe nga e dhëna se Agjencia më 2014 ka paraqitur 93 kallëzime penale, kurse nga to gjykatat kanë trajtuar dhe vendosur vetëm 12 raste.

Sidoqoftë, Agjencia mbetet e përkushtuar në përmbushjen e misionit të saj ligjor dhe shprehë gatishmërinë që të bashkëpunojë me institucionet e drejtësisë, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Vërejtje:

Për detaje në lidhje me lëndët e Mos deklarimit ose deklarimit të rrejshëm të pasurisë, sipas nevojës dhe interesimit, shprehim gatishmërinë që t'ju ofrojmë informacione shtesë.

Me respekt!